



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KRYETARI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPËSTINA OPŠTINE
SKENDERAJ
Nr. No. 01-060/01-0019797/24
Data Date 22.04.2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës 28.03.2024, ora 14:00.

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Propozim-vendim për bartjen e mjeteve nga kategoria rezerva në kategorinë e projekteve kapitale, Nr.04-400/01-0014787/24, dt. 21.03.2024, (Raporton Drejtori i DBF, **z.Ismet Aliu**);
5. Propozim-vendim për Formomini e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushta) e Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr. 02-020/01-0013489/24, të datës 12.03.2024, (Raporton Kryetari i Komunës, **z.Fadil Nura**);
6. Propozim-vendim për Themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për shqyrtimin e ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet e Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr.02.020/01-0013678/24, datë 13.03.2024, (Raporton Kryetari i Komunës, **z.Fadil Nura**);
7. Propozim-vendim për Themelimin e komisionit të kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale, me Nr.02-020/01-0013528/24, me Nr.13.03.2024, (Raporton Kryetari i Komunës, **z.Fadil Nura**);
8. Propozim-vendim për Themelimin e komisionit të Kuvendit Komunal për shqyrtimin e ankesave përkitazi me zgjedhjen e Këshillave Lokale, me Nr.02-020/01-0013526/24, të datës 13.03.2024, (Raporton Kryetari i Komunës, **z.Fadil Nura**);
9. Propozim-venim për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Skenderajt për vitin 2024-2028, me Nr.12-052/01-0014807/24, të datës 21.03.2024, Raporton Drejtoresha e DZHENIT-së, **znj.Besarta Meha-Ademi**);
10. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahi: I nderuar kryetar i komunës z. Fadil Nura, të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, shoqëri civile dhe gjithë ju të pranishëm, Kjo seancë është thirrur në ora 10:00, po është shtyre për ora 14:00, për arsye të agjendës në Izbic. Shkojmë në konstatime të kuorumit në sallë janë 27 anëtar, mungon me arsye Armir Sejdiu, Arjeta Rama dhe Alketa Mecini, ndërsa bashkëngjitet gjate seancës Ragip Durmishi. Shkojmë me miratimin e rendit ditës, e hap debatin, fjalën ja kalojë:

Afrim Kabashi-NSD: Fjala përshëndetëse, Unë kisha pas dëshirë sot me qenë drejtori i bujqësisë po nuk është, po e kam obligim moral me shtjellua rastin e seancës së kaluar, që me tha që nuk ke të drejtë dhe referoju UA, dhe UA Nr.7/2011 për regjistrimin e fermave të datës 25.08.2011 në piken 8.5 thotë: një fermer duhet të ketë një nifë, dhe në raste së keni dy apo me shume nifa brenda një ferme ABZH-ja merr vendim për refuzimin e dy apo me shume fermerëve

dhe sanksionon sipas legjislacionit në fuqi, këtë UA, e ka nënshkrua ish Ministri i Bujqësisë Memli Krasniqi me datën 12.12.2016.

Kryesuesja; Dikush tjetër nëse nuk ka, konstatohet me (22) vota për, (0) kundër dhe (3) abstënim, Miratohet Rendi i Ditës.

Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës,

Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara, e hapë debatin, nëse nuk ka konstatohet me (26) vota për, (0) kundër dhe (1) abstënim, miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës,

-Propozim-vendim për bartjen e mjeteve nga kategoria rezerva në kategorinë e projekteve kapitale, me Nr.04-400/01-0014787/24, të datës 21.03.2024, (Raporton);

Drejtori i DBF-së Ismet Aliu; Fjala përshëndetëse, para vete e keni Propozim-vendim për bartjen e mjeteve nga kategoria rezerva në kategorinë e projekteve kapitale, në shume prej 90,000.00€, duke u bazuar në ligjin për ndarjen buxhetore për vitin 2024, Transferi i mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezerva, burimi i financimit (10) nga nën-programi: Infrastruktura rrugore (18023), me kod funksional (0451), shuma 90,000.00 €. Të Transferohen në kategorinë e shpenzimeve kapitale, burimi i financimit (10) në nën-programin: Në nën-programin Buxhetimi 17523, kodi funksional 0112 në projektin; Fondi i bashkëfinancimit (DFEZH-ja), kodi i projektit (43870), shuma 90,000.00€. Këto mjetet në kategorinë rezerva kanë mbete në këtë kategori pasi që projekti i propozuar, “Vendosja e trafove për sigurimin e ujit të pijes në BL të Likocit” është cilësuar si kompetencë e kompanisë publike energjetike, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja; E hap debatin, nëse nuk ka, konstatohet me (16) vota për, (8) kundër dhe (0) abstënim miratohet Propozim-vendim për bartjen e mjeteve nga kategoria rezerva në kategorinë e projekteve kapitale, në shumë prej 90,000.00€.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit të ditës:

-Propozim-vendim për Formomini e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushta) e Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr. 02-020/01-0013489/24, të datës 12.03.2024, (Raporton);

Kryetari i Komunës, Fadil Nura; Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Propozim-vendim për Formomini e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushta) e Dëshmorëve të UÇK-së, në përbërje prej pesë anëtar, një (1) anëtar nga ekzekutivi nga DSHMS-së, që do të jetë shefi i mirëqenies sociale, Albinot Mehmeti, i cili do të udhëheq procedurën administrative, një (1) anëtar nga shoqëria civile nga Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, dhe tre (3) anëtar nga kuvendi, dy (2) anëtar nga pozita, dhe një (1) anëtar nga opozita, Detyrat e këtij komisionit është që të bëjë shpalljen e thirrjes publike, shqyrtimin e aplikacioneve, përzgjedhjen e përfituesve sipas kriterëve të përcaktuara në thirrje, si dhe punën e këtij komisioni ka me vlerësua kuvendi komunal në fund.

Kryesuesja; E hap debatin, fjalën ja kaloj;

Hysni Mehani-LVV: Po besoj që është një prej vendimeve shume të ndihshme, dhe besoj që na kish dashtë edhe ndihma e zyrës ligjore, së duhet me pas parasysh së kemi anëtar të kuvendit që është familjar i dëshmorëve që i takon banesa dhe duhet me u specifikuar që mu ruajte prej konfliktit të interesit? Dhe propozoj që ky komision me i pas 7 anëtar që me u shtua edhe për dy anëtar nga kuvendi dhe besoj që përfshirja sa me e gjerë nuk e dëmton procesin po veç i ndihmon? Gjithashtu mendoj së para se të dhurohen banesat të behën kriteret, p.sh. banesa që dhurohet nuk ka të drejt të shitet, të mos lëshohet me qira, dhe mos të lehet bosh, dhe është shume e rëndësishme që të behet një diskutim për kriteret, që mos me hap një farë debati-lufte kogja të gjanë që ka me i shkaktua shume pakënaqësi që këna me i dëmtua një prej kategorieve me të ndjeshme?.

Abdulla Gashi-IDEAL: Fjala përshëndetëse, Kryetar, kisha kërkuar një sqarim, sa kohe mundet me shkua që këto banesa të jenë të gatshme për me ju dhënë familjeve të dëshmorëve? A e din numrin e saktë sa dëshmor janë, në komunën e Skenderajt, dhe sa banesa kanë me u dhënë? A keni me ja lenë duart e lira komisionit për me i përcaktua kriteret apo do të fokusoni edhe ju aty, dhe kisha kërkuar nga komisioni i cili zgjidhet, nuk e di kush zgjidhet së besoj së ju i keni ato matematikat e juaja, që të jetë shume i drejtë, së besoj që kjo kategori është me e vlefshmja.

Floriana Halili-VV: Fjala përshëndetëse, a ka qenë e parapare me përfundua tri ndërtesat fillimisht, pastaj të jepen familjarëve të dëshmorëve, nëse po, perse po u jepen banesat vetëm për “U”, çka do të ndodh me ndërtesën “Ç” dhe “K” kur planifikohen të nisen dy ndërtesat e reja në pronat e lartë cekura?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Fjala përshëndetëse, z.Mehani, e shtroj një çështje me rendësi, që unë e diskutova me grupin parlamentar, shmangia e konfliktit të interesit, në rastet e anëtarëve të komisionit, janë anëtar të familjeve të dëshmorëve, që aje anëtar të tërhiqet nga vendimmarrja, dhe masi kemi anëtar tjerë mos me qenë anëtar i komisionit, e diskutuam dhe nuk kemi nevojë për zyre ligjore. Sa i përket rritjes së anëtarëve të komisionit, nuk besoj që këtë problem e zgjidh kuantiteti shumica, po e zgjidh kualiteti, 5 anëtar nëse e kryen punën mirë, do të bëjnë vlerësimin korrektë, dhe kur të bien listën në kuvend kemi me bisedua bashkërisht. Kur të përfundon procesi final marrim vendim, dhe atë në vendim me një nen e cekim që banesën nuk mundeni me shitë. Nuk kisha pas dëshirë me paragjykua, nuk e kam nis këtë proces me indicje, dhe ky proces e tejkalon çdo bindje politike, përveç dokumentacionit që ka me u prezantua nga familjarit, ju garantoj dhe ka me mbështet komisionin. Janë 128 banesa, ndërtimi është në fazën finale, dhe shpërndarja po mendoj me bë me 18 qershor ditën e çlirimit dhe ditën e dëshmorëve, nëse arrin komisioni me i përfundua procesin e përzgjedhjes, po komisionin nuk ka me ngut veç le të benë punën mirë. Projekti tjetër i ndërtimit është koga i kushtueshëm i kemi bë kërkesë qeveris me na ndihmua, nuk na ka përkrah, dhe me këto kapacitete që i kemi e kemi përfundua këtë objekt, dhe vitin tjetër që kemi mundësi qoftë me qeverinë kemi me vazhdua edhe me dy projektet tjera. Numrin e familjeve të dëshmorëve nuk ta thamë së nuk jam përgjegjës, unë jam kryetar i komunës, që e kam dhënë një premtim para këtyre familjeve dhe unë ka me mbajt dhe jam tu e mbajt.

Kryesuesja: replikë 1 min.

Hysni Mehani-VV: Sa do që ud. Kryetarit po fole më qetësi, këtu po shihet që ka tendencë me u përjashtua opozita e me pas fuqinë e vendimmarrjes, nëse ky proces garanton që është në rregull do duhej me qenë edhe përfaqësuesit e tri subjekteve politike, pra unë si anëtar i VV, jam i interesuar me qenë pjesë e komisionit, po tash këtu është ideja me u përjashtua VV. Ku ti si përgjegjës je pajtua për një vendim në parim dhe e ki dikan të ekzekutivit e dy përfaqësues të subjektit tuaj politik, atëherë pavarësia e komisionit është formalitet punën që ka me bë komisioni, për mendimin tim, kur ushtruesi kryesor i një institucioni pajtohet në parim këta tjerët kanë me ja bë veç aminin, kështu e thotë logjika.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: z.Mehana nëse ti nuk e dinë kush është organi vendimmarrës në këtë rast, e që edhe ti ke me qenë organ vendimmarrës, unë e kam një anëtar nga ekzekutivi që ka me i krye procedurat administrative, edhe një anëtarë nga shoqatat e dalura nga lufta, qysh po mendon ti me dy anëtar të kuvendit e ty metë dhënë te drejtën e vendimmarrjes ah, ku ke pa ti në demokraci, unë kisha pas dëshirë me participua edhe opozita me një anëtar, lista IDEAL, me

një anëtar dhe dy anëtar nga pozita. Lista ka metë ardhur 7 ditë para miratimit verifikoj çdo familje, dhe ka metë përkrah që ke informacione të dokumentuara.

Kryesuesja: Shkojmë me propozim, nga pozita, fjalën ja kaloj:

Liridona Koci-PDK: Fjala përshëndetëse, për anëtar të komisionit nga pozita propozoj Miradije Buliqi-PDK dhe Besiana Thaçi-PDK.

Kryesuesja: Shkojmë me propozim, nga opozita, fjalën ja kaloj:

Naser Bajraktari-IDEAL: Fjala përshëndetëse kryesuese, para se me shkua me propozime e pata një pyetje, a doni me votua këto komisione si avazin e vjetër një nga një, a doni me votua komisionin pako?

Kryesuesja: Naser nëse ka me shume së tre propozime, votohet një nga një, nëse janë tre propozime votohet pako komisioni, fjalën ja kaloj:

Naser Bajraktari-IDEAL: Për anëtar të komisionit nga opozita propozoj Musa Fazliu-IDEAL.

Kryesuesja: A ka propozime tjera, fjalën ja kaloj:

Floriana Haliti-VV: Për anëtar të komisionit nga opozita propozoj Hysni Mehani-VV.

Kryesuesja: A ka propozime tjera, nëse nuk ka, shkojmë në votim një nga një së janë me shumë së tri propozime:

-Konstatojmë me (22) vota për, (0) kundër dhe (2) abstenim, Miradije Buliqi, është anëtarë e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushta) e Dëshmorëve të UÇK-së.

-Konstatojmë me (22) vota për, (0) kundër dhe (2) abstenim, Besiana Thaçi, është anëtarë e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushta) e Dëshmorëve të UÇK-së.

-Konstatojmë me (25) vota për, (0) kundër dhe (2) abstenim, Musa Fazliu, është anëtar i komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushta) e Dëshmorëve të UÇK-së.

-Konstatojmë me (7) vota për, (6) kundër dhe (2) abstenim, Hysni Mehani, nuk është anëtar i komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushta) e Dëshmorëve të UÇK-së.

-Shkojmë në votim pako konstatojmë me (26) vota për, (2) kundër dhe (0) abstenim miratohet Propozim-vendim për Formomini e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushta) e Dëshmorëve të UÇK-së, me këtë përbërje:

1. **Albinot Mehmeti** - anëtar nga ekzekutivi (DShMS), Shefi i mirëqenies sociale,
2. **Miradije Buliqi** - anëtare nga legjislativi, PDK,
3. **Besiana Thaçi** - anëtare nga legjislativi, PDK,
4. **Musa Fazliu** - anëtar nga legjislativi, IDEAL,
5. **Brahim Misimi** - anëtar nga shoqëria civile (ShFD e UÇK-së).

Vazhdojmë me piken 6 të rendit të ditës:

-Propozim-vendim për Themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për shqyrtimin e ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet e Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr.02.020/01-0013678/24, të datës 13.03.2024, (Raporton);

Kryetari i Komunës, Fadil Nura; Para vetes e keni Propozim-vendim për Themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për shqyrtimin e ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet e Dëshmorëve të UÇK-së, në përbërje prej 3 anëtarëve nga kuvendi, dy (2) të pozitës e një (1) të opozitës. Detyrat e komisionit është që të bëjë shqyrtimin e të gjitha ankesave nga data e parashtrimit të ankesës, t'u kthej përgjigje me shkrim parashtruesve të ankesave, si dhe për punën e tij t'i raportoj Kuvendit të Komunës.

Kryesuesja: Faleminderit, e hape debatin nëse nuk ka shkojmë me propozime, fjalën ja kaloj:

Liridona Koci-PDK: Për anëtar të komisionit nga pozita propozoj Besart Rrecaj-PDK, dhe Ferdane Beqiri-Emini-PDK:

Kryesuesja: Shkojmë me propozim, nga opozita, fjalën ja kaloj:

Naser Bajraktari-IDEAL: Për anëtar të komisionit nga opozita propozoj Osman Smajli-IDEAL:

Kryesuesja: A ka propozime tjera, fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-VV: Ajo çka është e rëndësishme që vullneti jonë si subjekt politik VV, është me u përfshi në këto komisione, të paktën në njërin prej këtyre dy komisioneve, po këtu po dihet po ju pengon VV, ne rregull jemi.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kryetarit të Komunës, Fadil Nura: z. Mehani nëse e ke vullnetin me qenë pjesë e këtij komisioni edhe unë jam i gatshëm dhe propozoj që ky propozim-vendim me ndryshua dhe me u bë prej 3 anëtarëve të kuvendit në 5 anëtar të këtij komiteti, të shtohet edhe një anëtar nga pozita dhe një anëtar nga opozita, që edhe z. Mehani të jetë pjesë i këtij procesi, dhe besoj që ka me na ndihmua.

Kryesuesja: Shkojmë në votim për propozimin e kryetarit për ndryshimin e propozim vendimit prej 3 anëtarëve të kuvendit, të behën 5 anëtar te kuvendit në këtë komision, konstatojmë me (26) vota për, (1) kundër dhe (1) abstenim, përkrahët propozimi i kryetarit që të behën prej 3 anëtarëve të kuvendit, të behën 5 anëtar te kuvendit të ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet e Dëshmorëve të UÇK-së. Kërkojë edhe një propozim nga pozita, dhe opozita, fjalën ja kaloj:

Liridona Koci-PDK: Për anëtar të komisionit nga pozita propozoj Selim Tahiri-PDK:

Floriana Haliti-VV: Për anëtar të komisionit nga opozita propozoj Hysni Mehani-VV.

Kryesuesja: Faleminderit, dikush tjetër, nëse nuk ka, me qenë se janë 5 anëtar shkojmë në votim pako, konstatojmë me (28) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim miratohet Propozim-vendim për Themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për shqyrtimin e ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet e Dëshmorëve të UÇK-së, me këtë përbërje:

1. **Besart Rrecaj** - anëtar nga legjislativi, PDK,
2. **Ferdane Beqiri-Emini** - anëtare nga legjislativi, PDK,
3. **Osman Smajli** - anëtar nga legjislativi, IDEAL,
4. **Selim Tahiri** - anëtar nga legjislativi, PDK,
5. **Hysni Mehani** - anëtar nga legjislativi, VV.

Vazhdojmë me piken 7 të rendit të ditës:

-Propozim-vendim për Themelimin e komisionit të kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale, me Nr.02-020/01-0013528/24, me Nr.13.03.2024, (Raporton);

Kryetari i Komunës, Fadil Nura; Para vetes e keni Propozim-vendim për Themelimin e komisionit të kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale, katër (4) anëtar nga kuvendi nga subjektet e ndryshme, një (1) anëtar nga ekzekutivi. Detyrat e komisionit është që të bëjë koordinimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave Lokale dhe për punën e tij i raporton Kuvendit Komunal. Jemi tu bë përpjekje që kryetarëve të fshatrave me gjete një zgjidhje me pagua një mëditje, së për ndryshe nuk ka interesim dhe është problem me i zgjedh.

Kryesuesja: E hap debatin, nëse nuk ka, shkojmë me propozim, nga pozita dhe opozita, fjalën ja kaloj:

Kushtrim Dragaj-PDK: Për anëtar të komisionit nga pozita propozoj Liridona Koca-PDK, Fikret Rexhepi-PDK, dhe Besiana Thaçi-PDK.

Naser Bajraktari-IDEAL: Për anëtar të komisionit nga opozita propozoj Abdulla Gashi-IDEAL.

Hysni Mehani-VV: Propozimi i anëtarit të PDK-së, është në kundërshtim me piken një (1) të propozim-vendimit, ku thotë; katër (4) anëtarë të kuvendit nga subjektet e ndryshme politike, e ftojë kolegun me i tërheq propozimet. Për anëtare të komisionit propozoj Floriana Halili-VV:

Kryesuesja: Hysni, ka drejt subjekti me propozua me shume së një anëtar, me qenë së kemi me shume së katër propozime shkojmë në votim një nga një.

-Konstatojmë me (23) vota për, (0) kundër dhe (1) abstenim, Liridona Koci është anëtarë e komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale.

-Konstatojmë me (23) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, Fikret Rexhepi është anëtar i komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale.

-Konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër dhe (2) abstenim, Besian Thaçi është anëtarë e komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale.

-Konstatojmë me (23) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, Abdulla Gashi është anëtar i komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale.

-Konstatojmë me (10) vota për, (4) kundër dhe (9) abstenim, Floriana Halili nuk është anëtarë e komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokale.

-Shkojmë në votim pako konstatojmë me (26) vota për, (0) kundër dhe (2) abstenim miratohet Propozim-vendim për Themelimin e komisionit të kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale me këtë përbërje:

1. **Ilmi Kabashi** - anëtarë nga ekzekutivi,
2. **Liridona Koci** - anëtare nga legjislativi, PDK,
3. **Fikret Rexhepi** - anëtar nga legjislativi, PDK,
4. **Besiana Thaçi** - anëtare nga legjislativi, PDK,
5. **Abdulla Gashi** - anëtar nga legjislativi, IDEAL,
6. **Milazim Mustafa** - anëtar nga shoqëria civile, dhe
7. _____ një anëtar nga lokaliteti (fshatë, vendbanim apo lagje), ku të mbahen zgjedhjet.

Vazhdojmë me piken 8 të rendit të ditës:

-Propozim-vendim për Themelimin e komisionit të Kuvendit Komunal për shqyrtimin e ankesave përkitazi me zgjedhjen e Këshillave Lokale, Nr.02-020/01-0013526/24, dt.13.03.2024, (Raporton)

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Propozim-vendim për themelimin e komisionit të Kuvendit Komunal për shqyrtimin e ankesave përkitazi me zgjedhjen e Këshillave Lokale, edhe në këtë komision i kemi parapa 3 anëtar të kuvendit, Detyrat e komisionit është që të bëjë shqyrtimin e të gjitha ankesave dhe brenda afatit prej 15 ditësh nga data e parashtrimit të ankesës, t'u kthej përgjigje me shkrim parashtruesve të ankesave, si dhe për punën e tij t'i raportoj Kuvendit.

Kryesuesja: E hap debatin nëse nuk ka, vazhdojmë me propozime, fjalën ja kaloj:

Liridona Koci-PDK: Për anëtar të komisionit nga pozita propozoj Kushtrim Dragaj-PDK, dhe Mentor Mehmeti-PDK:

Naser Bajraktari-IDEAL: Për anëtar të komisionit nga opozita propozoj Ilir Ejupi-IDEAL:

Kryesuesja: Faleminderit, a ka propozime tjera nëse nuk ka, shkojmë në votim pako Konstatojmë me (24) vota për, (2) kundër dhe (0) abstenim miratohet Propozim-vendim për Themelimin e komisionit të Kuvendit Komunal për shqyrtimin e ankesave përkitazi me zgjedhjen e Këshillave Lokale, me këtë përbërje:

1. **Kushtrim Dragaj** - anëtar nga legjislativi, PDK,
2. **Mentor Mehmeti** - anëtar nga legjislativi, PDK,
3. **Ilir Ejupi** - anëtar nga legjislativi, IDEAL.

Vazhdojmë me piken 9 të rendit të ditës:

-Propozim-venim për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Skenderajt për vitin 2024-2028, me Nr.12-052/01-0014807/24, të datës 21.03.2024, (Raporton);

Drejtoresha e DZHENIT-së, Besarta Meha-Ademi: Fjala përshëndetëse, para jush e keni Propozim-venim për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së

Skenderajt për vitin 2024-2028, jemi mundua të jemi sa me real dhe planifikimet të jenë në bazë të kapaciteteve buxhetore, kjo strategji bazohet në këto 6 shtylla, siç, zhvillimi ekonomik, zhvillimi i arsimit shëndetësisë, bujqësisë, kulturë, rini e sport, dhe zhvillim urbanistik, materialin e keni pas me kohe, strategjia i ka kalua afatet ligjore të diskutimit publik, kush ka pyetje jemi këtu për përgjigje.

Kryesuesja: E hap debatin, fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-VV: Atëherë kur i kam pa do dujë të sanës në shkollë kam besua që është një gabim, po në Strategjinë për zhvillim ekonomik lokal parashihen në faqen 32 që shkollat kanë me u dhënë për bujqësi edhe këna me i pa shkollat në të ardhmen të shndërruar në ferma, ju kisha lutë këtë marre me ndal, shkollat kanë kuptim e trashëgimisë të kulturës të historisë, po jo me u kthye në ferma. A mundesh drejtoresh me mi tregua në bazë të cilave kritere ja keni dhënë kësaj kompani me bë Strategjinë për zhvillim ekonomik lokal 2024-2028? Edhe nëse e shihni që është ma skandalozja është që kjo kompani, apo ju, është tu dashtë me fye krejt këtyre këshilltarëve komunal, por edhe me ja fye edhe të ardhmen qytetarëve, së vjen me një punim që i ka marrë të dhënat krejt prej wikipedias, mundeni me hi me shikua. Me ardh me ti marr projekt 8 mijë €, që është e pa falshme qysh e keni tolerua, ose dikush i ka marr paret e ka thanë letë banë hajgare ky këtu. Pra me një punim prej wikipedias ta ka marr projektin në vlerë 8 mijë€, ky në këtë punim as nuk din ku fillon as ku mbaron, as nuk e din çka donë, ky flet kotë në këtë punim, shi çka thotë të faqja 13; sipas të dhënave të fundit në ARBK, nga viti 2000 e deri me tani në Komunën e Skenderajt, janë regjistruar mbi 3700 biznese prej të cilave 1422 janë aktiv, 834 janë shuar, kurse të tjerat janë pasiv, pra aktualisht në komunën e Skenderajt veprojnë 600 biznese, që po i bien zhvillimi i vonshëm janë shkua 3100 biznese. Nuk po mundem me besua qysh ke mundur me tolerua me ja propozua këtë kuvendit, shiko çka thotë në faqen 12; Falë natyrës në këtë rajon nuk ka ndonjë lum, shtrati i të cilit mund të jetë kërcënues i tokave, po neve ke tu na qua lumi, ky nuk ka të dhëna e ju po doni me na prezantua këtu. Ju kisha lutë që këtë propozim vendim me tërheq dhe me dërgua në polici-prokurori për dallavere ka tentua me ju mashtrua, ose jeni pjesë e kësaj, edhe aj është sa për sy e faqe e dikush i merr paret, ndryshe kjo nuk ka shpjegim.

Afrim Kabashi-NSD: Edhe unë jam munduar me hi me lexuar këtë dokument, po është i pa thukte i pa kuptimte, nuk e di kush është kjo kompani që e ka bë këtë dokument që ish krejt copi, past, edhe të bujqësia nuk e di çka thotë, konsultoni me kompaninë e përmisone e sjellëni një dokument ma te detajuar.

Mentor Mehmeti-PDK: Fjala përshëndetëse, unë e kam lexuar strategjinë e përgëzoi drejtoreshën që e ka sjell këtu, edhe e dini që strategjia ka dal në diskutim publik një muaj, dhe fatkeqësia me e madhe është që si qytetar nuk hina me i shikua e me i jap sugjerimet tona. Unë i kam pas dy shqetësime, të gjeodezia e katastri ku thotë digjitalizimi i katastrit dhe ligji e parasheh që agjencinë me pas këtë sa na ndihmon e sa na përkrah, kurës si propozim e kam që çdo gjë e kulturës të digjitalizohet me vende historike, varreza, dëshmoret që përmes telefonit me lexua historinë.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtoresha e DZHENIT-së, Besarta Meha-Ademi: Faleminderit prej të gjithëve, sa i përket përzgjedhjes së kompanisë nuk e di saktësisht qysh ka shkua së ato janë procedura të prokurimit. Sa i përket asaj pjese së hyrjes ku janë të dhënat që e kanë një referencë realisht nuk janë të dhëna që sigurohen prej agjencisë dhe nuk është që mund me i be kjo kompania, nuk po e arsyetoj po kjo kompani nuk mundet me i siguria të dhënat e ngjashme po dihet që çdo punim e ka edhe një përshkrim të realitetit. Sa i përket fjalës tende që ka të bëjë me lumin po e marr si vërejtje me ndryshua. Faleminderit Mentor për idetë besojë që kemi me i pas parasysh, ndërsa të

pjesa e projekteve edhe propozimeve janë përfshi të gjithë zyrtaret dhe drejtoret edhe ata i kanë marrë të gjitha sugjerimet e tyre dhe janë përfshi të pjesa e projekteve.

Kryesuesja: Replikë Imin.

Hysni Mehani-VV: Rregullorja kërkon që 8 muaj i merr kohe veç procedura për me bë këtë Strategji, dhe këtu nuk ka referencë dhe në këtë dokument fjalë për fjalë është copi, past, nëse ti thua që është e vërtetë ajo në wikipedia që në ish sistemin e Jugosllavisë ka qenë me mirë së tash në komunën e Skenderajt dakort, po kjo nuk është ashtu është marrë, shiko çka thotë; Problemi me ujë fermerët po e përdorin ujin po nuk është i mjaftueshëm edhe i sigurt, a e dini që përdorimi i ujit të pijes për ujitjen është vepër penale, unë jam i bindur që këtë dokument së ke lexuar, po edhe nëse e ke lexua këtë strategji e ke kalua se di çka të thamë, po jam i sigurt që se ke lexua së këtu ka skandal.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: z. Mehani, sqaroma pak mua punën e ujit, se nuk kesh në sall.

Hysni Mehani-VV: A beson ti që përdorimi i ujit të pijes për ujitjen e tokave bujqësorë është vepër penale, është e dënueshme?

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Me thanë që uji i pijes për ujitje është vepër penale është gabim, ti vetëm paguaje ujin, e ti ujite token, është ora që i matë shpenzimet, dhe e vërteton sa ke shpenzua uji, dhe nuk është vepër penale ujitja e tokës me ujë të pijes. Vepër penale është kur ti nuk ke orë dhe e ke përdor edhe së paguan ujin. Dokumenti i strategjisë nuk po thamë që është e përkryer dhe ju ftoj që me dhënë mendime, propozime, dhe e plotësojmë aty ku ka nevojë.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (10) vota për, (10) kundër dhe (0) abstenim miratohet Propozim-venim për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Skenderajt për vitin 2024-2028.

Vazhdojmë me piken 10 të rendit të ditës:

-Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme, fjalën ja kaloj;

Afrim Kabashi-NSD: Pyetje për ekzekutivin e komunës 1. Pyetje Për Drejtorin e Arsimit, Kastriot Duraku; Drejtor a ka mundësi të na njoftoni nëse keni informata, a pritjet të filloje në këtë vite projekti I shume përfolur Çerdhja e fëmijëve në fshatin Polac?

2. Pyetje Për Drejtorin e Urbanizmit Driton Mulaj dhe kryetarit të komunës ; Drejtor a mund të na njoftoni konkretisht a keni ndonjë plan apo afat të caktuar në rifillimin e punimeve në zgjidhjen e çështjes së kanalizimit në disa lagje të fshatit Polac e ku është duke u zvarrit kjo punë që sa kohe?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj,

Drejtori i DKA-së, Kastriot Duraku: Afrim ne i kemi dorëzuar të gjitha dokumentacionet e kërkuara për çerdhe në MASH-ë, parcela e cila kërkohet të ndërtohet çerdhja është pronë e agjencisë të pyjeve, kemi bë kërkesë për pëlqim në agjension dhe jemi tu e pritë përgjigjen, dhe me vazhdua me leje të ndërtimit.

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Afrim në vitin 2022 është nënshkruar një kontratë me operator janë kanë të parashikuara 18km kanalizim neper të gjitha fshatrat, këna punuar në Polac, Marin, Makerrmal, Rezallë, Krasmiroc, Runik, ajo kontrat ka përfundua jemi në procedurë me shpallë tenderin që e ka titullin “Kanalizimi në Lagjet e fshatit Polac”.

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Punimet e kanalizimit në Polac të lagja Veliqt nuk kanë filluar sepse ka probleme pronësore, kështu që kemi me i zgjedh këto probleme.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj,

Abdulla Gashi-IDEAL: 1.Pyetje për drejtorin e DKA-së-Skenderaj, Kastriot Duraku; Pse ju si drejtor i keni dërguar mesazh Drejtorëve të Shkollave që pjesëmarrja për 5, 6, dhe 7 Marsin e Lavdishëm të Jasharajve të jetë në grupe të vogla, jo e gjithë stafi i shkollës me nxënës, A është kjo një tendencë dashakeqe nga ana juaj me porosi politike kundër Familjes Jashari apo çfarë?
2. Pyetje për Fadil Nuren: A mund të na sqaroni pse nuk iu keni përgjigjur pozitivisht Ministrisë së Kulturës për bashkëpunim në organizimin e Epopesë së UÇK-së?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj,

Drejtori i DKA-së, Kastriot Duraku: Si çdo herë të gjitha shkollat e qytetit atë që janë afër me Prekazin kanë shkuar në mënyrë të organizuar në Epopenë e UÇK, në Prekaz, komplet stafi dhe nxënësit, ndërsa shkollat që gjenden neper fshatra kanë shkuar me staf me të vogël për arsye së nuk ka transport për të gjithë nxënësit.

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Lenë familjen Jashari të qetë, se nuk ka të bëjë kjo me politik qysh e keni bë. Kush të ka thanë që ka ftesë, a keni ftesë nëse ki ftesë ka pa dufte me ja bashkëngjite pyetjes, a e dini që na kanë hekë, unë për 7 vite kam qenë anëtarë i këshillit organizativ nen patronatin e qeveris kam marr pjesë, a e ke pa vendimin publik që u kanë, na një javë e kana pritë për me shti në agjendë qeveritare rastin e busteve të Sale e Hamit Jashari dhe nuk kemi marr përgjigje, unë i kam të gjitha shkresat me emaila me krejt, krejt këtu çka ke kërkua ti është e kundërta ta dëshmoj.

Kryesuesja; Faleminderit, dikush tjetër, nëse nuk ka, me kaq mbyllet ky takimi, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi

